

**VENDIM**  
**Nr. 12/2014**

**PËR SHPALLJEN SI TË PAVLEFSHËM TË VENDIMIT NR. 1/2013 TË KUVENDIT “PËR  
ZGJEDHJEN E INSPEKTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE”**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, të nenit 105, 116 dhe 117 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurës Administrative”, si dhe të nenit 111 të rregullores së Kuvendit, me kërkesën e një grupi deputetësh,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Shpalljen si të pavlefshëm të vendimit nr. 1/2013 të Kuvendit “Për zgjedhjen e inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive” dhe, për rrjedhojë, rregullimin e pasojave juridike të krijuara në këtë mënyrë:

- a) lirim nga detyra të inspektoreve të përgjithshme të ILDKPKI-së znj. Zana Xhuka;
- b) votimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 7928, datë 16.1.2013 “Për propozimin e inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ilir Meta**

Miratuar në datën 20.2.2014